



# BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.10

Gusht 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

**I. Materiale të shqyrtuara e të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datën 16. 7. 2004**

*PROJEKTLIGJE*

**(Vendime për propozime projektligjesh Kuvendit të Shqipërisë)**

**1. Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal (i ndryshuar)**

- Shtesat dhe ndryshimet kanë për qëllim:

Trajtimin bashkëkohor të organizatës kriminale, grupit të organizuar kriminal dhe formave të tjera të bashkëpunimit në krim. Përkufizimin e qartë të krijimit, organizimit dhe antarësimit në organizata e grupe kriminale si dhe të përcaktimit të hollësishëm të formave të krimit të organizuar, i qëllimeve ekonomike dhe joekonomike, politike e terroriste të grupimeve kriminale. Parashikimin e sanksioneve etj.

**2. Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale" (i ndryshuar).**

*(Vijon në faqen 2)*

## Ftesë e Hapur për Bashkëpunim

Ministria e Ekonomisë në mbështetje të:

Ligjit Nr. 8810, datë 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom";

Ligjit Nr.9127, datë 29.07.2003 "Për disa shtesa në ligjin nr.8810 datë 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom";

Ligjit Nr.9117, datë 24.07.2003, "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Armo Fier";

dhe të programit të punës së Qeverisë Shqiptare ka përgatitur draftin e paketës së akteve nënligjore për privatizimin e dy shoqërive të rëndësishme që funksionojnë në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare,

*(Vijon në faqen 8)*

**Në këtë numër do të lexoni:**

**1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave  
faqe 1-5**

**2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore  
faqe 1**

**3. Ftesë e Hapur për Bashkëpunim  
faqe 1 dhe 8**

**4. Nga punimet e Kuvendit për periudhën 16-30 korrik 2004  
faqe 6-7**

## Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë  
[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

Këshilli i Ministrave  
[www.keshilliministrave.al](http://www.keshilliministrave.al)

Presidenca  
[www.president.al](http://www.president.al)

Bashkia e Tiranës  
[www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Ministria e Punëve të Jashtme  
[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

Ministria e Shëndetësisë  
[www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Ministria e Rendit Publik  
[www.mpo.gov.al](http://www.mpo.gov.al)

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit  
[www.mpvd.gov.al](http://www.mpvd.gov.al)

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit  
[www.mtt.gov.al](http://www.mtt.gov.al)

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

- Ndryshimet e propozuara kanë për qëllim:

Përmirësimin e kapaciteteve dhe teknikave për zbulimin, hapjen dhe dënimin e anëtarëve të krimeve të rënda. Garantimin e jetës dhe përfitimeve të tjera për dëshmitarët apo për personat të cilët janë përfshirë në këto krime, por që pranojnë të bashkëpunojnë me drejtësinë.

Konfiskimin e të gjitha pasurive të përfituara nga veprimtaritë kriminale si dhe goditjen e bazës ekonomike që godet krimin e organizuar etj.

**3.** Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar.

Ky projektligj është pjesë e paketës së reformës penale ose e paketës "anti-mafia" dhe ka për qëllim vendosjen e rregullave dhe masave të posaçme ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikëve, terrorizmit dhe korrupsionit.

Projektligji parashikon sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që burojnë nga krimi i organizuar, nëpërmjet një procedure administrative, gjithashtu është parashikuar detyrimi i zotëruesve të pasurive kriminale që të vërtetojnë e justifikojnë prejardhjen e ligjshme të burimeve financiare. E rëndësishme është ideja që hidhet lidhur me krijimin e një Komiteti Këshillues për masat kundër krimit të organizuar, i cili do të drejtohet nga kryeministri.

**4.** Për kriteret e pranimit, karrierën dhe ndërprerjen e saj në Shërbimin Informativ Ushtarak.

- Projektligji i shërben implementimit sa më të mirë të ligjit bazë "Për Shërbimin Informativ Ushtarak" duke evidentuar dhe përcaktuar procedura mbi pranimin, karrierën e punonjësve dhe ndërprerjen e saj.

**5.** Për një ndryshim në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat".

- Sipas ndryshimit:

Rritja e akcizës së cigareve me 5 lekë do të çojë në një përafrim të saj me nivelin minimal të vendeve të rajonit, duke mbetur ende larg vendeve të BE-së. Gjithashtu rritja e akcizës do të japë afate në rritjen e atë ardhurave tatimore me një nivel rritje mesatarisht 900 milion në vit.

## Vendime të Këshillit të Ministrave

**1.** "Për pranimin në universitetet dhe shkollat e larta, në sistemin me shkëputje nga puna, si dhe për tarifën e shkollimit, për vitin akademik 2004-2005.

**2.** Për rritjen e masës së shpërbllimit të veteranëve të luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqipëtar. **3.** Mbi ndryshimin e kalimit të përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve të bazave ndihmuese të Sarandës dhe Shëngjinit.

**4.** Për transferimin në pronësi të Bashkisë Bajram Curri të mjedisve të ish-Shtabit të Brigadës së Këmbëorisë në Bajram Curri, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në VKM nr. 515 datë 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

**5.** Për transferimin në pronësi të Bashkisë Pukë të mjedisve të ish-Hotelit të Ushtarakëve dhe të ish-Degës së Mobilizimit në Pukë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në VKM nr. 515 datë 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

**6.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve.

**7.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Malit të Zi, për bashkëpunim në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm dhe aktiviteteve të tjera ilegale.

**8.** Për miratimin në parim të Dokumentit të Ndryshimeve në Marrëveshjen e Grantit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si Administruese e Fondeve për projektin e Ruajtjes së liqenit të Ohrit dhe Procesverbalin e Bisedimeve Përkatëse.

**9.** Për miratimin e "Marrëveshjes për Zhvillim dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendbanimin Patos-Marinjë".

**10.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për KQZ-në për financimin e zgjedhjeve të pjesëshme për Kryetar Komune, në Komunën e Udëmishtit, të Qarkut Korçë.

**11.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, për financimin e konferencës vjetore të ACEEEO-së

## **12. – deri – 19**

Për listën e inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, në juridiksionin territorial dhe administrativ.

Shënim: Titulli është i njëjtë për të 8 bashkitë e komunat që mbajnë numrin rendor nga 12 deri 19. Bashkitë e komunat janë: Bashkia-Ura Vajgurore, Tepelenë, Vau i Dejës, Shijaku, Manze, Memaliaj; Komuna: Guri i Zi, Ishmi.

**20.** Për transferimin e fondeve buxhetore Bashkisë Elbasanit, për

(Vijon në faqen 3)

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 2)*

mbulimin e shpenzimeve Administrative të Qendrës Sociale “Balashe”.

## **II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 23. 7. 2004**

### *PROJEKTLIGJE*

#### **(Vendime për propozime projektligjesh Kuvendit të Shqipërisë)**

**1.** Për ratifikimin e protokollit shtesë të “Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në traktatin e Atlantikut të veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre.

**2.** Për ratifikimin e konventës nr.173, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, “Mbrotjtja e pretendimeve të punëtorëve në rast falimentimi të punëdhënësit.” 2002.

**3.** Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Transportit Ajror, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë së Turqisë, për shërbimet ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve respektive.

**4.** Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e kartagjenës për biosigurinë, të konventës “Për larminë biologjike”.

#### **Vendime të Këshillit të Ministrave**

**1.** Për shpërndarjen me koeficiente të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Kamberi CO”, sh.p.k, në administrim me të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve.

**2.** Për miratimin e “Memorandumit të Mirkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

**3.** Për miratimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Mold-

avisë, për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore”.

**4.** Për miratimin në parim të konventës ndërkombëtare “Për asistencën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore”.

**5.** Për miratimin e përdorimit të fondeve të llogarisë “Escrow” të Agjencisë Shqiptare të garancisë, nga Fondacioni “Besa” dhe Unioni Shqiptar i Kursim –Kredisë.

**6.** Për miratimin në parim të “Marrëveshjes së grantit italian, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për bashkëfinancimin e projektit të dytë të punëve të komunitetit”.

**7.** Për kufizimin e shpenzimeve buxhetore të vitit 2004.

**8.** Për miratimin e “Marrëveshjes së konçensionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjitikës e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit si organ shtetëror i autorizuar (OSHA), dhe shoqërisë “Wonder”, sh.a, për ndërtimin e hidrocentralit të Sarajt”.

**9.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të rrugëve të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë për vazhdimin e punimeve në rrugën Milot-Rrëshen segment i aksit rrugor Durrës-Kukës-Morinë.

**10.** Për lejimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për restaurimin e Amfiteatrit të Durrësit dhe për restaurimin pjesor të Qytetit - Muze të Gjirokastrës.

## **III. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 30. 7. 2004**

### *PROJEKTLIGJE*

#### **(Vendime për propozime projektligjesh Kuvendit të Shqipërisë)**

**1.** Për ratifikimin e Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje

me përpunimin automatik të të dhënave personale”.

- Konventa i siguron në territorin e çdo shteti palë, çdo individ, pavarësisht nga kombësia apo vendndodhja, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, në veçanti të drejtën për jetën e tyre private, në lidhje me operacionet e përpunimit automatik të të dhënave personale.

**2.** Për ratifikimin e Protokollit Shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.

**3.** Për pranimin nga Republika e Shqipërisë të Rezolutës A. 724 (17) “Për ndryshimet e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare Detare dhe Aneksit të saj” 1991.

- Ndryshimet e Konventës sigurojnë një bashkëpunim më të mirë ndërmjet shteteve në të gjitha aspektet e transportit detar dhe tregtar, si dhe nxisin standardet më të larta në drejtim të sigurisë dhe efektivitetit të lundrimit.

**4.** Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8732, datë 24.1.2001 “Për Materialin Mbjellës Bimor”.

- Ndryshimet në ligj synojnë të përmirësojnë sistemin e prodhimit të materialeve mbjellëse bimore, duke ndihmuar në krijimin e një konkurrencë të ndershme për të çuar tek fermerët materialin mbjellës bimor sa më cilësor. Gjithashtu rregullohet edhe problemi i dhënies së lejes për Riprodhim e Shumëzim të materialit mbjellës bimor.

#### **Vendime të Këshillit të Ministrave**

**1.** Për masën dhe mënyrën e kompensimit të qirasë së banesës dhe të ushqimit të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

**2.** Për procedurën e aplikimit për regjistrimin e lëndëve plasëse në

*(Vijon në faqen 4)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 3)*

regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil.

**3.** Për disa ndryshime në vendimin nr.243, datë 26.3.2004, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore për vitin 2004 dhe për rishpërndarje fondësh buxhetore”.

**4.** Për disa shtesa në vendimin nr.182, datë 25.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për çmimet e shitjes së barnave” (i ndryshuar).

**5.** Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Këshillin e Ministrave.

**6.** Për disa ndryshime në vendimin nr. 771, datë 13.11.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.

**7.** Për një ndryshim në vendimin nr. 684, datë 13.12.2001, të Këshillit të Ministrave për Këshillin Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore” (i ndryshuar).

**8.** Për rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin 2004.

**9.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Kërkesë për kuotim”, për kryerjen e punimeve në rrugën Sopat-Tropojë-Qaf Morinë.

**10.** Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Kërkesë për kuotim”, për sistemimin, asfaltimin e rrugës së Novakës.

**11.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Kërkesë për kuotim”, për ndërtimin e rrugës Papër-Vidhas, loti I, pjesa e aksit rrugor Rrogozhinë –Elbasan.

**12.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Kërkesë për kuotim”, për ndërtimin e rrugës Papër-Vidhas, loti II, pjesë e aksit rrugor Rrogozhinë –Elbasan.

**13.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Kërkesë për kuotim”, për sistemimin e asfaltimin e rrugës Vlorë-Orikum.

**14.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Kërkesë për kuotim”, për ndërtimin e rrugës Rrogozhinë-Lushnjë, loti I.

**15.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Kërkesë për kuotim”, për ndërtimin e rrugës Rrogozhinë-Lushnjë, loti II.

**16.** Për lejimin e Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për objektin në shitje Dukat.

**17.** Për klasifikim e veprimtarisë dhe për dokumentacionin e procedurën për dhënien e lejes nga inspektori i punës, para vënies në punë të ndërmarrjes.

**18.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Moldavisë për bashkëpunim në fushën e turizmit.

**19.** Për miratimin e marrëveshjes së përgjithshme të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite.

**20.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për objektin “Sistemin – asfaltim rruga e Kuçit”.

**21.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për sistemimin

dhe asfaltimin e rrugës Sarandë-Jergucat.

**22.** Për lejimin e Ministrisë së Rendit Publik të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për blerje armatimi dhe municioni.

**23.** Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë.

**24.** Për lejimin e institucioneve buxhetore të përdorin procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për blerje gazoli.

**25.** Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2004, për Ministrinë e Drejtësisë, për rritjen e kapaciteteve të burgjeve të Peqinit dhe të rrogozhinës.

## **IV. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 12. 8. 2004** *PROJEKTLIGJE*

### **(Vendime për propozime projektligjesh Kuvendit të Shqipërisë)**

**1.** Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për ripranimin e personave.

- Kjo marrëveshje nxit dhe thellon bashkëpunimin dypalësh në nivel rajonal, për goditjen me efikasitet të fenomenit të migrimit të paligjshëm.

**2.** Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së republikës së Maqedonisë, për bashkëpunim në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme.

- Nga përmbajtja e marrëveshjes, del se ajo në tërësi i shërben nxitjes dhe thellimit të bashkëpunimit dypalësh në nivel rajonal, për

*(Vijon në faqen 5)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 4)

goditjen me efikasitet të këtyre llojeve te kriminalitetit.

**3.** Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për Përgjegjësinë Civile për Dëmet nga Ndotjet me Karburant" 1992".

- Aderimi në këtë Konventë do të sigurojë mbrojtjen e shtetasve të zonave bregdetare dhe të shtetit në rastet e ndotjeve që mund të shkaktohen nga karburantet në det.

**4.** "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për krijimin e fondit ndërkombëtar për kompensimin e dëmeve nga ndotjet me karburant" 1992".

- Konventa e fondit siguron kompensim për dëmet e shkaktuara nga ndotjet me karburant, lehtëson pronarët e anijeve për barrën shtesë të kompensimit dhe ndihmon në zbatimin e konventës për Përgjegjësinë Civile. Fondi sigurohet nga Kontributet e subjekteve që furnizohen me karburant nëpërmjet detit.

**5.** Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen "Për Transportin Ndërkombëtar të Rastit të Udhëtarëve me autobus. (Marrëveshja INTERBUS).

- Marrëveshja ka për qëllim të krijojë lehtësira për udhëtarët që udhëtojnë me autobus, ndërmjet shteteve të KE-së dhe shteteve jo anëtare të KE, si edhe shteteve që janë palë kontraktuese të kësaj marrëveshje ndërmjet tyre.

**6.** Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Athinës për transportin e Pasagjerëve dhe Bagazheve të tyre në det"- 1974 dhe Protokollat e viteve 1976, 1990 dhe 2002.

- Konventa dhe Protokollat shtesë mbron udhëtarët duke u siguruar se do të çdëmtohen dhe do t'u kompensohen dëmet që mund t'u shkaktohen në anije gjatë udhëtimit. Ajo detyron transportuesit të mbajnë përgjegjësi për dëmet ose humbjet që pësojnë

pasagjerët, nëse shkaktojnë për to është pakujdesia e transportit.

## Vendime të Këshillit të Ministrave

**1.** Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2004-2015.

**2.** Për miratimin e modelit tranzitor të Tregut të Energjisë Elektrike.

**3.** Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve të konçesionit për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, të naftës jellësve dhe gazsjellësve.

**4.** Për ristrukturimin e KESH-it sh.a dhe për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171. datë 19.4.2002 "Për miratimin e dokumentit të politikave të sektorit Elektroenergjitik".

**5.** Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Koresë, për huatë nga fondi i bashkëpunimit për zhvillim ekonomik dhe të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Koresë, për një hua nga fondi i bashkëpunimit për zhvillim ekonomik.

**6.** Mbi statutin e ushtarakut me gradë madhore të Forcave të Armatosura pas daljes në lirim.

**7.** Mbi rritjen e pagës kalimtare të ushtarakut në rezervë (lirim).

**8.** Për miratimin e procedurës, të mënyrës dhe të dokumentit të shtesave në ndërtime.

**9.** Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 19.11.1998 "Për miratimin e Rregullores së urbanistikës.

- Shtesat e propozuara kanë të bëjnë me detyrimin që subjektet ndërtues dhe subjektet shtetërore që japin lejen për sheshin e ndërtimit dhe lejen e shfrytëzimit, të marrin në konsideratë rregullat, normat dhe standardet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

**10.** Për miratimin në parim të Konventës nr. 97, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, "Për migracionin në punësim".

**11.** Për një ndryshim në vendimin nr.485, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e fondeve buxhetore Bashkisë së Elbasanit, për mbulimin e shpenzimeve administrative të qendrës sociale "Balashe".

**12.** Për një ndryshim limiti në fondet e kushtëzuara, miratuar në buxhetin e vitit 2004, për Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

**13.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Vath Koreshi jash-të shtetit.

**14.** Për një ndryshim në vendimin nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë".

**15.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Presidencën.

**16.** Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.334, datë 29.5.2003 "Për shpronësimin për interes të pasurive të paluajtshme, që preken nga segmenti rrugor Piraj-Kthesa Vau i Dejës (Pjesë e superstradës Lezhë -Shkodër)".

**17.** Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.246, datë 24.4.2003 "Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Balldre-Piraj (Pjesë e superstradës Lezhë -Shkodër.)

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-30 KORRIK 2004

**1. Dekret i Presidentit të Republikës për kthimin e ligjit nr.9235, datë 8.6.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" (shqyrtuar në seancat plenare të datave 22 dhe 29 korrik 2004).**

Kuvendi shqyrtoi në seancë plenare Dekretin e Presidentit të Republikës për kthimin e ligjit nr.9235, datë 8.6.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" në parim dhe vendosi që ai të shqyrtohet nga komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare për çdo çështje që parashtron. Lidhur me çështjet që shtrohen në dekret, Kuvendi shqyrtoi edhe propozimet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste dhe nga disa deputetë për ndryshime dhe amendime në ligj. Çështjet kryesore që u shqyrtuan ishin:

**Së pari**, në dekretin e Presidentit të Republikës propozohet rishikimi i nenit 16, pika 1/a dhe 3 të ligjit nr.9235, sipas të cilit Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e komisioneve vendore. Sipas dekretit, ankimi kundër vendimit të komisioneve vendore duhet të bëhet në gjykatë. Nëse Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës do t'i jepej kompetenca e shfuqizimit të vendimeve të komisioneve vendore, situata do të komplikohet, pasi nuk është përcaktuar në ligj se cili do të jetë vendimi që ankimohet, ai i komisionit vendor apo ai i Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës dhe se a mund të jenë të dy vendimet të ankimueshme.

Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare shumica e deputetëve mbështetën vërejtjet e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, në të cilat propozohet që formulimi i bërë në nenin 16, pika 1/a dhe 3 të mbetet siç është në ligj, pasi ai i jep Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave një kompetencë të domosdoshme, duke qenë se ai është organ superior i komisioneve vendore. Kjo çështje është formuluar mbështetur në variantin e OSCE-së dhe është në përputhje me ndërtimin e tërë praktikës administrative. Ata theksuan se dhënia e kësaj kompetence nuk krijon mundësi abuzimi, pasi në pikën 3 të nenit 16 janë përcaktuar rastet kur duhet të ushtrohet kjo kompetencë.

Deputetët e opozitës mbështetën dekretin e Presidentit për këtë çështje. Në përfundim, Kuvendi miratoi me shumicë votash qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për këtë çështje.

**Së dyti**, Dekreti i Presidentit të Republikës propozon rishikimin e nenit 16, pika 2 të ligjit, sipas të cilit Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës ka të drejtë të verifikojë vendimet e komisioneve që kanë zbatuar ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" dhe ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe t'i shfuqizojë ato ose të kërkojë shfuqizimin e tyre në rrugë gjyqësore. Sipas dekretit, ky formulim le hapësirë për riv-

lerësim edhe një herë të procedurave administrative dhe gjyqësore të ndërmarra që prej vitit 1991 e këtej në zbatim të ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Kjo e drejtë, sipas dekretit, mund t'i jepej Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave vetëm në rastet kur një pronë e shtetit u është kthyer padrejtësisht individëve. Në raste të tjera ky rregullim bie në kundërshtim me parimet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, ku një palë e tretë, siç është Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës, do të ndërhynte pa patur interesa të drejtpërdrejta në çështje.

Gjatë diskutimit shumica e deputetëve ishin të mendimit se formulimi i bërë në këtë pikë nuk bie ndesh me ligjet në fuqi dhe se kjo e drejtë i duhet dhënë Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, pasi ka patur mjaft raste abuzive dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi. Kjo e drejtë është e kufizuar në kohë dhe jepet vetëm në rastet që kërkohet nga organet e pushtetit vendor ose nga subjektet e shpronësuar. Në rastet e praktikave që kanë përfunduar me titull pronësie të hipotekuar, do të jetë vetëm procesi gjyqësor që do të marrë vendimin përfundimtar. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ishte që formulimi edhe mund të rishikohet, duke e kufizuar kompetencën e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në verifikimin e vendimeve të komisioneve vendore vetëm për procedurat e zbatimit të ligjit nr.7698 dhe të ligjit nr.7501.

Deputetët e opozitës mbështetën dekretin e Presidentit të Republikës për këtë çështje. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi me shumicë votash që pika 2 e nenit 16 të qëndrojë siç është. Por, në mënyrë që kjo e drejtë të zbatohet vetëm në rastet e ankimimit, Kuvendi vendosi që pika 4/a e nenit 16 të hiqet, pasi ajo i jep një kompetencë të zgjeruar Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, që të shfuqizojë vendimet e komisioneve vendore kur ato kanë shkelur dispozitat që rregullojnë juridiksionin dhe kompetencat e tyre.

**Së treti**, Dekreti i Presidentit të Republikës propozon rishqyrtimin e nenit 15 të ligjit, për shkak se ai nuk përcakton rastet dhe mënyrën e shkarkimit të anëtarëve të Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës, si dhe rastet e zëvendësimit të anëtarëve të këtij Komiteti. Këto çështje, sipas dekretit, duhen përcaktuar në ligj dhe nuk i duhen lënë interpretimeve ligjore, të cilat mund të sjellin pështjellime të panevojshme politike.

Në lidhje me këtë çështje, deputetët u shprehën se vërejtja është e drejtë dhe miratuan shtesën e një pike në nenin 15 të ligjit, e cila përcakton rastet e shkarkimit të anëtarëve të Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës. Formulimi u mbështet në vërejtjet e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe në amendamentin e paraqitur nga deputeti Maksim Begeja.

**Së katërti**, Kuvendi shqyrtoi edhe nenin 15, pika 1 të ligjit, i cili përmban formulën e krijimit të Komitetit  
(*Vijon në faqen 7*)

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-30 KORRIK 2004

*(Vijon nga faqja 6)*

Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës. Deputetët e opozitës u shprehën kundër formulimit të parashikuar në ligj për këtë pikë dhe propozuan që përmbajtja e saj të jetë në përputhje me projektligjin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave, sipas të cilit Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi. Një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës, dy anëtarë propozohen nga pozita dhe dy anëtarë nga opozita parlamentare. Anëtari i propozuar nga Presidenti është Kryetar i Komitetit.

Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ishte që Komiteti të përbëhet nga 6 anëtarë, të cilët të emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi i Shqipërisë, 3 anëtarë propozohen nga mazhoranca, 3 anëtarë propozohen nga opozita. Kryetari i Komitetit zgjidhet nga Kuvendi. Pas diskutimit, Kuvendi vendosi me shumicë votash të mos e ndryshojë formulimin e pikës 1 të nenit 15 të ligjit, i cili parashikon në përbërje të Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës pesë anëtarë, dy prej të cilëve propozohen nga pozita, dy anëtarë nga opozita dhe një anëtar i propozohet nga Këshilli i Ministrave Presidentit të Republikës, i cili e dërgon për miratim me dekret në Kuvend. Anëtari i sjellë nga Presidenti dhe i miratuar nga Kuvendi është edhe kryetar i tij.

## **2. P/ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve” (miratuar në seancë plenare më 29 korrik 2004)**

Ky projektligj ka për objekt rregullimin ligjor të organizimit dhe të funksionimit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, që më parë ka qenë rregulluar me ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit”. Ai synon rritjen e pavarësisë institucionale dhe operacionale të Komisionit Mbikëqyrës të Sigurimeve, i cili në këtë projektligj propozohet të emërtohet “Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve”.

Në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit çështja kryesore për të cilën u debatua kishte të bënte me varësinë e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve. Deputetët diskutuan rreth dy varianteve:

- Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve të jetë institucion i pavarur nga Këshilli i Ministrave, duke e vendosur atë në varësi të Kuvendit;

- Të jetë organ në varësi të Këshillit të Ministrave.

Ata theksuan se varianti i parë i jep pavarësi institucionale më të madhe Autoritetit. Por, në kushtet kur tregu i sigurimeve nuk është ende i konsoliduar, për të realizuar mbikëqyrjen e këtij tregu, i cili është mjaft sensibil, është e nevojshme që Autoriteti të jetë në varësi të Këshillit të Ministrave. Me këtë argument, Kuvendi miratoi variantin e dytë, atë të varësisë së këtij institucioni nga Këshilli i Ministrave.

Gjithashtu, Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit diskutoi nëse duhet të kishin një ligj të posaçëm për Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve apo ai të parashikohej si pjesë përbërëse e ligjit “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit” dhe vendosi që të miratojë variantin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave, i cili e parashikon ngritjen e këtij institucioni me ligj të veçantë.

Kuvendi diskutoi dhe miratoi një sërë ndryshimesh në nenet e projektligjit, të cilat synojnë përmirësimin e përmbatjes së tij.

## **3. P/ligji “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit” (miratuar në seancë plenare më datë 29 korrik 2004)**

Ky projektligj zëvendëson ligjin në fuqi nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimeve dhe/ose risigurimeve” dhe synon hartimin e një ligji më të plotë në fushën e sigurimeve dhe të risigurimeve, duke e përshatur atë me standardet e Bashkimit Europian. Ai plotëson dispozitat e ligjit ekzistues në disa drejtime, si: siguron përputhje të së drejtës për të themeluar një shoqëri sigurimi me direktivat e BE-së, përmirëson dispozitat për licencimin e shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit, si dhe dispozitat për drejtimin dhe funksionimin e shoqërive të sigurimit dhe për kontrollin e brendshëm, parashikon rregullim ligjor të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, parashikon dispozita për rregullat e menaxhimit të rrezikut, parashikon rregulla për administrimin e përkohshëm, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë së sigurimit etj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, duke u konsultuar me specialistët që kanë punuar për përgatitjen e tij dhe duke marrë në konsideratë ekspertizën e specialistëve të Bankës Botërore, Kuvendi miratoi një sërë amendamentesh që përmirësojnë përmbajtjen e tij.

## **4. P/ligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar (miratuar në seancë plenare më datë 29 korrik 2004)**

Projektligji parashikon rritjen e akcizës së cigareve nga 20 në 25 lekë për paketë, duke e përafuar nivelin e akcizës me vendet e tjera të rajonit, me qëllim rritjen e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit. Nisur nga këto argumente, ai u mbështet nga shumica e deputetëve të maxhorancës.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin, me argumentin që rritja e nivelit të akcizës së cigareve do të ndikojë në rritjen e evazionit fiskal dhe të kondrbandës, si dhe do të dëmtojë prodhimin vendas. Sipas tyre, rritja e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit duhet të arrihet nëpërmjet forcimit të disiplinës në mbledhjen e tatimeve dhe takave nga administrata tatimore e doganore dhe zgjerimit të bazës së tatueshme, duke përfshirë në sistemin e tatimtaksave edhe ata biznesmenë që i shmangen pagimit të detyrimeve ligjore.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

# Ftesë e Hapur për Bashkëpunim

(Vijon nga faqja 1)

Albtelekom Sh.A. dhe ARMO Sh.A. Kjo paketë, e cila sipas ligjeve të mësipërme do të miratohet nga Këshilli i Ministrave, është hartuar duke u bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare si dhe në funksion të një privatizimi sa më të suksesshëm me synim realizimin e një procesi transparent, me pjesëmarrje të gjerë dhe konkurrese i cili do të garantojë realizimin e investimeve të domosdoshme për zhvillimin afatgjatë të këtyre shoqërive dhe ekonomisë shqiptare. Nëpërmjet kësaj pakete aktesh nënligjore përcaktohen madhësia e paketës që do t'u ofrohet investitorëve strategjikë, kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e dy shoqërive dhe çështje të tjera që lidhen me përdorimin e të ardhurave nga procesi i privatizimit.

Duke vlerësuar rolin tepër të rëndësishëm që këto shoqëri kanë për ekonominë e vendit, Ministria e Ekonomisë, në kuadër të transparencës me publikun, hap këtë proces bashkëpunimi më të gjitha palët e interesuara për të dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim.

Nëse ju jeni një organizatë, institucion, shoqatë, pedagog, student, jurist, ekonomist, inxhinier apo çdo in-

divid, brenda apo jashtë Shqipërisë, që mendoni se mund të jepni kontributin tuaj për përmirësimin ekësaj pakete të rëndësishme aktesh nënligjore, jeni të ftuar për të paraqitur idetë tuaja duke marrë pjesë në këtë bashkëpunim të hapur i cili do të vijojë dhe me një konferencë kombëtare mbi këtë temë, që do të zhvillohet së shpejti nga Ministria e Ekonomisë. Për të marrë falas një kopje të paketës ju mund të:

Dërgoni një kërkesë me shkrim praën Ministrisë së Ekonomisë.

Kërkoni me telefon ose faks në numrat tel 36 46 33 / 36 46 39 që një kopje t'ju vihet në dispozicion.

Dërgoni një mesazh elektronik në:

[privatizim\\_transparent@miek.gov.al](mailto:privatizim_transparent@miek.gov.al) dhe ne do t'ju përgjigjemi duke ju dërguar paketën në formë elektronike.

Kaloni pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe mund të merrni një kopje të paketës në zyrën nr.14, kati V.

Duke çmuar kontributin tuaj dhe falenderuar për bashkëpunimin, mirëpresim çdo sugjerim, koment apo vërejtje për këtë paketë aktesh nënligjore, të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe zhvillimin afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

## Njoftim

**Të nderuar zonja e zotërinj,**  
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohe, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë:

"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.

Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP."

### Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator  
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; [cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdpd.org](http://www.ascdpd.org)